



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3647/11 prot.

Datë 06.01.2025

V E N D I M

Nr. 07/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.01.2025 me

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër.3647 prot., datë 16.12.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-27062-10-29-2024, me objekt: “Supervizion punimesh për objektin :“Furnizimi me ujë i fshatrave Goricaï, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolate, Gradisht, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e re ne Njesine Gradisht”, me fond limit 4,741,428.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 15.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SH.A.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SH.A.

Adresa: Lagja " 18 Tetori " Lushnje".

Ankimues

Operatori ekonomik “HTS COMPANY” SHPK me NIPT M11619018P dhe adresë: Lagjia "Mustafa Matohiti", banesa nr.31, shkalla nr 1, ish Konvikti, Tepelenë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.10.2024 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-27062-10-29-2024, me objekt: “Supervizion punimesh për objektin :“Furnizimi me ujë i fshatrave Goricaj, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolate, Gradisht, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e re ne Njesine Gradisht”, me fond limit

4,741,428.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 15.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.

II.2. Në datën 15.11.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 25.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "ZENIT&CO" SHPK	4,000,605.4	kualifikuar
2. BOE "Bn Project & Hydro-Eng Consulting"	4,000,605.34	skualifikuar
3. "G B Civil Engineering" SHPK	4,000,605.34	skualifikuar
4. "HTS COMPANY" SHPK	4,000,605.34	skualifikuar
5. "M.A.K STUDIO" SHPK	4,000,605	skualifikuar
6. "NET-GROUP" SHPK	4,000,605.34	skualifikuar
7. BOE "STATENG & "MCE" SHPK	4,051,589.96	skualifikuar

Operatori ekonomik "HTS COMPANY" SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, për arsyen si më poshtë:

"Operatori Ekonomik Shoqëria " HTS COMPANY" shpk nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike, rezulton se Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk është llogaritur në perputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" duke qënë se oferta ekonomike është nën kufirin minimal të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kesaj VKM, kërkesë kjo e cila bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 "Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016".

II.4. Në datën 13.12.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4888 dhe nr.3647/2024 prot, datë 16.12.2024, si dhe ankimi nr. A/2024/4890, si dhe nr.3647/1/2024 prot, datë 16.12.2024 i operatorit ekonomik "HTS COMPANY" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga nga operatori ekonomik "HTS COMPANY" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 3647/3, datë 16.12.2024.

II.7.Me shkresën nr 3647/4 prot., datë 23.12.2024, me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A duke i kërkuar informacion si më poshtë: “... Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me administrimin e kësaj ankese pranë institucionit tuaj si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”.

II.8. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, me shkresën nr. 1487/11 prot, datë 18.12.2024 me objekt: “Mbi plotësimin e të metave të ankesës”, protokolluar me tonën me nr. 3647/5 prot datë 24.12.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën drejtuar operatorit ekonomik ankimues lidhur me plotësimin e të metave të ankesës (kryerjen e pagesës mbi ankimin e paraqitur).

II.9. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.1708/1prot., datë 26.12.2024, me objekt “Kthim përgjigje” , protokolluar me tonën me nr. 3647/7 prot., datë 31.12.2024 ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe shkresën nr.1487/11 prot., datë 18.12.2024 me objekt “ Mbi plotësimin e të metave të ankesës” drejtuar operatorit ekonomik ankimues për kryerjen e pagesës lidhur me ankesën e paraqitur.

II.10. Në datën 26.12.2024, nëpërmjet shërbimit postar operatori ekonomik ankimues “HTS COMPANY” SHPK ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën nr. 120 prot, datë 26.12.2024 me objekt: “Kthim përgjigje tuajës 3647/2prot”, protokolluar me tonën me nr. 3647/6 prot datë 30.12.2024, duke u shprehur se: “Duke ju falenderuar për korrektesinë në lidhje me ankesën e bërë në sistem si dhe referuar Shkresës 3647/2 prot te ardhur në dt 26.12.2024 nga Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe shkresës Nr 1487/11 prot te ardhur në dt 26.12.2024 Shoqërisë rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A ju bejme me dije se:

Nga rillogaritja e vlerës së fondit për objektin " Supervizion punimesh për objektin : "Furnizimi me ujë i fshatrave Gorica, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolate, Gradisht, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e re në Njesinë Gradisht" pasi saktësuam koeficientet në rezulton se vlera e rrumbullakosur nga ana e Autoritetit kontraktor është korrekte.

Sa më sipër nuk kemi pretendime për rillogaritje të vlerës”.

II.11.Në datën 31.12.2024, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën e operatorit ekonomik ankimues “HTS Company” SHPK, nr.120 prot., datë 26.12.2024, me objekt “*Kthim përgjigje tuajës 3647/2prot*”, protokolluar me tonën me nr.3647/8 prot., datë 31.12.2024.

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues, “HTS COMPANY” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë, duke u shprehur “ *... se vlera e rrumbullakosur nga ana e Autoritetit kontraktor wshtw korrekte.Sa mw sipwr nuk kemi pretendime pwr rillogaritje tw vlerws*”, në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-27062-10-29-2024, me objekt: “Supervizion punimesh për objektin :“Furnizimi me ujë i fshatrave Gorica, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolate, Gradisht, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e re ne Njesine Gradisht”, me fond limit 4,741,428.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 15.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SH.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankesë dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij.

Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues “HTS COMPANY” SHPK, për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 3647 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimesi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-27062-10-29-2024, me objekt: “Supervizion punimesh për objektin :“Furnizimi me ujë i fshatrave Gorica, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolte, Gradisht, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e re ne Njesine Gradisht”, me fond limit 4,741,428.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 15.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

